

## **Hapet thirrja për aplikime për bursa shkëmbimi për stafin akademik të UT-së për mësimdhënie në Universitetin e Bordeaux Montaigne, në Francë**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa shkëmbimi për stafin akademik të UT-së për mësimdhënie në Universitetin e Bordeaux Montaigne, në Francë

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Staf Akademik për mësimdhënie, në fushën e Historisë dhe Arkeologjisë

### **Kohëzgjatja e mobilitetit:**

- 7 ditë;

### **Fushat e mobilitetit:**

Histori dhe Arkeologji.

Për t'u njohur me katalogun e programit të mobilitetit në fushën e sipërpërmendur dhe gjuhën në të cilën ai zhvillohet, klikoni në adresën:

<http://www.u-bordeaux-montaigne.fr/fr/index.html>

[http://www.u-bordeaux-montaigne.fr/fr/formations/offre\\_de\\_formation.html](http://www.u-bordeaux-montaigne.fr/fr/formations/offre_de_formation.html)

### **Mobiliteti përfshin:**

- Kompensimin 140 Euro në ditë;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- CV+ lista e publikimeve (në anglisht ose frëngjisht në varësi të programit të mësimdhënies);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në anglisht ose frëngjisht në varësi të programit të mësimdhënies);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze ose frënge, në nivelin B2, në varësi kursit që do të zhvilloni;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie (në anglisht ose frëngjisht);

*\*Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:*  
[http://www.uc.edu/content/dam/uc/international/images/Student\\_Team/StudyAbroad/faculty-and-staff/Bx\\_teaching%20contract.docx](http://www.uc.edu/content/dam/uc/international/images/Student_Team/StudyAbroad/faculty-and-staff/Bx_teaching%20contract.docx).

Afati për aplikim: 20 Shkurt 2017

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!